



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2022:075354

Datë: 19.09.2024

Numri i dokumentit: 06183646

C.nr.29/22

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH – Departamenti i përgjithshme, Divizioni civil, me gjyqtaren Sabaheta Kurteshi dhe bashkëpunëtorin profesional Gjelbrim Gërdellaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit N. T. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av. B. Sh. nga Prizreni, kundër të paditurës Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, me bazë juridike kompensimin shujtave ditore, vlera e kontestit 1,332.00 €, jashtë shqyrtimi, me dt. 19.09.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

-Për shkak të padëgjueshmërisë/ mosbindjes –

I. APROVOHET pjesërishtë si e bazuar kërkesëpadia e paditësit N. T. nga fshati..., Komuna e Dragashit, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit av. B. Sh. nga Prizreni.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Dragash, që paditësit N. T. nga fshati..., Komuna e Dragashit, në emër të kompensimit të shujtave gjatë punës për ditët e pranisë në punë për 337 ditë pune nga 2 € për secilën ditë të prezencës në punë, duke llogaritur prej dates 01.04.2019 deri me datën 03.03.2022, **t'ia paguajë paditësit shumën e përgjithshme prej 674.00 € (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër euro)**, me kamat ligjore duke llogaritur në lartësi 8%, duke filluar nga data e parashtrimit të padisë (14.04.2022), e deri në pagesën definitive, të gjitha në afat prej 7 ditësh nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përbarimit.

III. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit mbi shumën e gjykuar si në piken II. të dispozitivit të këtij aktgjykimi si e pa bazuar edhe atë për periudhën prej 18.04.2017 – 01.04.2019 për shkak të parashkrimit të kërkesës.

IV. DETYROHET e paditura Komuna e Dragashit – Drejtoria Komunale e Arsimit në Dragash, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 124,00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi N. T. nga fshati..., Komuna e Dragashit, përmes përfaqësuesit të autorizuar pranë kësaj gjykate ka ushtruar padi me 14.04.2022, kundër të paditurës Komuna e Dragashit - Drejtoria Komunale në Dragash, për pagesën e shujtave ditore, ku çështjen e ka paraqitur si në vijim:

Paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe atë në Shkollën Filllore të Mesme të Ulët (tutje: SHFMU) “9 M.” në fshatin..., Komuna e Dragashit në pozitën e mësimdhënësit. Tutje, ka

theksuar se e paditura Komuna e Dragashit përkundër obligimeve dhe të drejtat të cilat rrjedhin nga Kontrata Kolektive e Arsimit e datës 18.04.2017 dhe 03.03.22, konform dispozitave të nenit 35 pika 7 e kësaj marrëveshjeje, nuk ka bërë kompensimin e shujtave ditore dhe atë nga 2 euro për ditët e pranisë në punë, duke propozuar gjykatës aprovimin padisë dhe detyrimin e të paditurës që të bëjë pagesën e shpenzimeve të ushqimit.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore, pas shqyrtimit paraprak të padisë, ka nxjerrë aktvendimin për përgjigje në padi, C.nr.29/22 të datës 23.08.2024, me të cilin e ka detyruar të paditurën, që të përgjigjet në padi, të cilin e paditura e ka pranuar me datë 29.08.2024, duke e njoftuar të paditurën për detyrimin ligjor për dhënien e përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do të i ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, përkatësisht për mundësinë që gjykata të marrë aktgjykim për shkak të mosbindjes.

E paditura pavarësisht se e ka pranuar aktvendimin për përgjigje në padi, së bashku me padinë, provat materiale, në këtë çështje juridike kontestuese, nuk ka paraqitur përgjigje në padi brenda afatit ligjor.

Gjykata pasi i ka vlerësuar kushtet ligjore për nxjerrjen e aktgjykimit për shkak të mos bindjes, ka gjetur se në rastin konkret, plotësohen të gjitha kushtet ligjore, për nxjerrjen e aktgjykimit në fjalë, nga neni 150 par. 1, pikat a), b) dhe c) të LPK, e cila dispozitë në mënyrë shprehimore parasheh se: *“Nëse të paditurit i është dorëzuar padia dhe thirrja për përgjigje në padi, se themelësia e kërkesëpadisë del nga faktet treguara në padi dhe se faktet në të cilat mbështet kërkesëpadia, nuk janë në kundërshtim me provat të cilat i ka propozuar vet paditësi, apo me faktet e ditura botërisht”*.

Paditësja padisë ia ka bashkangjitur provat materiale si në vijim: vërtetimin e lëshuar nga Drejtori i shkollës së SHFMU ‘9 M..’ në fshatin..., me numër të protokolit 02/03-2022 i dt. 03.03.2022, kërkesën për pagesën e shujtave drejtuar Komunës së Dragashit - Drejtorisë Komunale të Arsimit dhe fotokopjen e letërnjoftimit dhe kartelën bankare të paditësit.

Nga provat e administruara më lart nuk është kontestues fakti se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura - shkolla fillore “9 M..” në fshatin..., Komuna e Dragashit, por mbetet kontestues fakti se paditësit a i takon kompensimi për ushqimin ditor për shujtat, për të cilën çështje gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, për shkak se kjo kërkesë e paditësit është e rregulluar me dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë 01/B nr.105 të dt. 22.01.2021, konkretisht të nenit 35.7, i cili rregullon të drejtën për shujtje-ushqim ditor për ditët e kaluara në punë, në rastet kur punëdhënësi nuk e ka organizuar ushqimin në punë sikurse në rastin konkret.

Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjyqjese dhe gjendjen faktike të vërtetuar, se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, ashtu që e detyroi të paditurën që paditësit t’ia kompensoj ushqimin ditor në shumën prej 674.00 €, duke e llogaritur një ditë pune me nga 2 €, për shkak se nga provat

materiale konkretisht vërtetimi Nr.02/03-2022 të datës 03.03.2022, vërtetohet fakti se paditësi për për periudhën nga data 01.04.2019 deri me datë 03.03.2022 ka punuar gjithsejtë 337 ditë.

Sa i përket vendimarrjes sipas pikës III të kërkesëpadisë, gjykata ka gjetur se paditësi ka paraqitur kërkesën (padinë) më dt. 14.04.2022, ndërsa kompensimin sa i përket shujtave e ka kërkuar nga 18.04.2017 e deri më 03.03.2022. Bazuar në nenin 7 të Ligjit të Punës që përcakton se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka pasur të drejtë të parashtrojë kërkesën duke llogaritur për 3 vite mbrapa nga dita e paraqitjes së saj.

Ndërsa sa i përket vlerësimit rreth shujtave gjykata ka vlerësuar se nga data 01.04.2019 – 03.03.2022 sa edhe ka qenë kërkesa e paditësit për ditet e pranisë në punë, për gjithsejtë 337 ditë pune nga dy (2) euro për një ditë, t’i paguaj shumën prej 674.00 euro për shujta dhe si i tillë një vlerësim për gjykatën ka qenë i thjeshtë dhe për këtë arsye edhe nuk ka angazhuar ekspertizë përkatëse financiare duke synuar para së gjithash ekonomizimin e procedurës.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke e aprovuar shumën përkatëse të kompensimit, duke e llogaritur me kamatë ligjore prej 8 %, bazuar në nenin 382 par. 1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (14.04.2022), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palës paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale bazohet në nenin 449, 452 dhe 453.1 të LPK-së, ku është obliguar pala e paditur që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës në shumën prej 124 €, dhe atë në emër të përpilimit të padisë 104 € dhe në emër të taksës për padi 20 €, bazuar në tarifën e OAK-së.

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 150.1 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI CIVIL
2022:075354, 19.09.2024**

G j y q t a r j a,

Sabaheta Kurteshi

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa e cila duhet të parashtrohet në afat prej 7 dite, nga dita e marrjes së të njëjtit, ndërsa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.